

VENDIM
Nr. 16, datë 17.2.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 17.2.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 21 (A) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Arben Frroku, përfaqësuar nga avokat Tonin Prendi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Rihapja e procesit gjyqësor dhe shfuqizimi i vendimeve nr. 73, datë 29.6.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë; nr. 00-2017-443, datë 8.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim pranë gjykatës kompetente, duke urdhëruar rigjykimin e saj me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 18, 30, 33, 42, pika 2, 43, 122, pika 2, 124, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, 134, pikat 1 dhe 2, 142, pika 1 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 4, 15, pika 2, 48 dhe 128 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); nenet 38, 71, 71/a, 71/c dhe 76, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Arben Frroku (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “c”, 25 dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*) (ligji i kohës në momentin e kryerjes së veprave penale).

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 52, datë 3.4.2015, ka vendosur deklarinimin të pafajshëm të kërkuarit për kryerjen e veprave penale për të cilat është

akuzuar, pasi, sipas saj, nuk është provuar se ai i ka kryer ato. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 73, datë 29.6.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 52, datë 3.4.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “c”, i KP-së dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm, si dhe të veprës penale “Prodhiimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, i KP-së dhe dënimin e tij me pesë vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, kërkuesi është dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2017-443, datë 8.6.2017, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se ai nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së.

5. Në datën 10.7.2017, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2017-443, datë 8.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në datën 18.12.2017, kërkuesi ka paraqitur shtesë objekti të kërkesës, duke kundërshtuar edhe vendimin nr. 73, datë 29.6.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, kërkesë që është pranuar nga Gjykata në seancën e datës 20.12.2017.

6. Në lidhje me bazueshmërinë ose jo në themel të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, gjatë votimit nuk u arrit kuorumi i nevojshëm ligjor, i parashikuar nga neni 72, pika 2, i Ligjit Organik të Gjykatës. Për rrjedhojë, me vendimin nr. 14, datë 24.4.2018 (*vendimi nr. 14/2018*) të Gjykatës, në bazë të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa u konsiderua e rrëzuar.

7. Në datën 20.6.2018, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) (*aplikimi nr. 30658/18, Frroku kundër Shqipërisë*), duke pretenduar cenimin e nenit 6, paragrafi i parë, të KEDNJ-së në drejtim të së drejtës së aksesit dhe asaj për të pasur një përgjigje të arsyetuar për pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues, për shkak të rrëzimit të kërkesës nga Gjykata për mosarritje të shumicës së kërkuar, duke mos arsyetuar kështu vendimin e saj. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të paanshmërisë, si dhe të parimit të prezumimit të pafajësisë.

8. Me vendimin e datës 4.2.2024, GJEDNJ-ja ka vendosur se nuk ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës në drejtim të aksesit në Gjykatë, pasi ankimi kushtetues i kërkuesit u rrëzua nga një trup gjykues prej gjashtë gjyqtarësh dhe kërkuesi u informua për rezultatin e votimit dhe pasojat e këtij rezultati për ankimin e tij. Për rrjedhojë, u konsiderua se kërkuesit nuk i ishte privuar e drejta për vendimmarrje për themelin e ankimit të tij (*shih paragrafin 19 të vendimit të GJEDNJ-së*). Përkundrazi, GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të kësaj dispozite (nenit 6, paragrafi 1, të Konventës) në të drejtën për një pasur një vendim të arsyetuar nga Gjykata, duke vlerësuar, bazuar edhe në çështje të tjera kundër Shqipërisë (*Meli dhe Swinkers Family Brewers N.V. kundër Shqipërisë*), se mungesa e arsytimit të përshtatshëm nuk plotëson kërkesat për një proces të drejtë (*shih paragrafët 14–15, të vendimit të GJEDNJ-së*). Kurse për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit për mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, cenimin e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë, si edhe parimit të prezumimit të pafajësisë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kërkuesi ka mundësi të kërkojë rihapjen e procesit përpara Gjykatës, çka mundëson, në parim, shqyrtimin e pretendimeve përmes një vendimi të arsyetuar. Në përputhje edhe me rolin subsidiar të saj, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të shqyrtojë këto pretendime, për sa kohë ai mund t’i paraqesë sërish përpara Gjykatës pas vendimmarrjes më të fundit për ankimin kushtetues në nivel të brendshëm (*shih paragrafët 21–22 të vendimit të GJEDNJ-së*).

9. Vendimi i GJEDNJ-së ka marrë formë të prerë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 41, datë 28.2.2025.

10. Në datën 8.4.2025, kërkuesi, bazuar në vendimin e GJEDNJ-së, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor penal të zhvilluar ndaj tij dhe shfuqizimin e vendimeve nr. 73, datë 29.6.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr. 00-2017-443, datë 8.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, në datën 5.6.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se është cenuar:

11.1 *E drejta e aksesit*, pasi gjykata e apelit nuk ka analizuar pretendimet e kërkuesit të paraqitura në apelin kundërshtues dhe nuk ka analizuar pse vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte i drejtë. Kjo e drejtë është cenuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit edhe pse në të ishin ngritur pretendime në lidhje me cenimin e procesit të rregullt ligjor nga gjykata e apelit.

11.2 *Parimi i paanshmërisë në gjykim*, pasi vendimmarrja e gjykatës së apelit është bazuar vetëm në ankimin e paraqitur nga organi i akuzës dhe nuk ka marrë në konsideratë apelin kundërshtues të kërkuesit. Ky parim është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, pasi gjyqtarët që kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit (Sh. S., A. Z., A. I. dhe T. N.) kanë marrë pjesë më parë në trupat gjykues që kanë shqyrtuar rekursin e ushtruara po nga kërkuesi gjatë fazës së hetimeve paraprake, për të cilat janë dhënë vendimet nr. 832, datë 13.6.2013 dhe nr. 15, datë 16.1.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në zbatim të neneve 15, pika 2 dhe 17, pika 1, shkronja “e”, të KPP-së ata gjyqtarë duhej të hiqnin dorë nga gjykimi i çështjes. Po ashtu, gjyqtarët Sh. S. dhe E. I. kanë shqyrtuar më parë një recurs tjetër të kërkuesit, që ka të bëjë me caktimin e masës së sigurimit ndaj tij, me vendimin nr. 1613, datë 20.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një procedim tjetër penal që ka lidhje me konfliktin që kërkuesi ka pasur me shtetasin D.L.

11.3 *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykata e apelit ka anashkaluar provat shkencore, konkretisht tre kamerat në vendngjarje dhe celulat e celularëve telefonik të vendndodhjes së telefonave të kërkuesit, duke ndryshuar edhe në thelb thëniet e dëshmitarit të mbrojtur. Gjykata e apelit ka marrë të mirëqena pretendimet dhe konkluzionet e organit të akuzës, pa analizuar pretendimet e mbrojtjes.

11.4 *Standardi i arsytimit të vendimeve gjyqësore*, pasi vendimi i gjykatës së apelit është i paarsyetuar, kontradiktor, alogjik dhe konfuz (*shih faqet 4 dhe 5 të vendimit*). Gjykata e apelit në vendimmarrjen e saj është në të njëjtat fakte dhe prova mbi të cilat është bazuar edhe gjykata e shkallës së parë, por pa analizuar se ku ka gabuar kjo e fundit. Gjykata e apelit, pa asnjë analizë, duke iu referuar eksperimentit hetimor, ka arritur në një përfundim të gabuar të kohëzgjatjes së segmentit rrugor të Qafë-Kërrabës. Ajo gjykatë, pa asnjë hetim gjyqësor ose veprim tjetër hetimor, ka ndryshuar vendndodhjen e dëshmitarit të mbrojtur dhe ka pranuar praninë e automjetit të tij shumë kilometra larg vendit të ngjarjes në kohën kur ka ndodhur ngjarja, por *a priori* arsyeton se nuk shquhet prania e kërkuesit. Duke vendosur mospranimin e rekursit vetëm me arsyetimin se pretendimet e ngritura nuk janë nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar këtë standard, pasi nuk ka dhënë asnjë shkak se përse nuk duhej pranuar rekursi i paraqitur nga kërkuesi.

11.5 *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi katër nga pesë gjyqtarët që kanë shqyrtuar rekursin për caktimin e masës së sigurimit, kanë shqyrtuar edhe rekursin për vendimin e themelit, çka përbën cenim të këtij parimi, pasi ata, në shqyrtimin e shkaqeve të rekursit, kishin krijuar bindjen e brendshme në lidhje me fajësinë e kërkuesit për veprat penale për të cilat akuzohej. Gjithashtu, akuza kundër kërkuesit është trajtuar mediatikisht, ku disa struktura politike kanë reflektuar opinion në lidhje me fajësinë e tij.

12. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

12.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit* në Gjykatën e Lartë është i pabazuar, pasi kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të rekursit, të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar në dhomën e këshillimit, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar për shkaqet e ngritura në të.

12.2 Edhe pretendimi tjetër për cenimin e *parimit të paanshmërisë* është i pabazuar, pasi vendimet nr. 832, datë 13.6.2013 dhe nr. 15, datë 16.1.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë dhënë për rekurset e paraqitura prej tij për masën e sigurimit personal dhe i takojnë një procesi të ndryshëm nga ai i paraqitur në këtë gjykim kushtetues. Pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në të dyja vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të paanshmërisë.

12.3 Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë përmban të gjitha elementet e një vendimi të arsyetuar, sipas jurisprudencës kushtetuese. Referuar të njëjtit vendim konstatohet se kërkuesi ka marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij.

12.4 I pabazuar është pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi nuk rezulton ndonjë e dhënë, e cila të tregojë se gjykatat e kanë filluar procesin penal me paragjykimin se kërkuesi ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Gjithashtu, nuk rezulton që gjykata të ketë kaluar barrën e provës nga prokurori tek i gjykuari ose të mos ketë vlerësuar dyshimet në favor të tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për rihapjen e procesit në Gjykatë

13. Gjykata vëren se referuar nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të Ligjit të saj Organik, nëse ajo ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, e cila paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit.

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues, duke mos përjashtuar edhe rastin e rihapjes së procesit sipas nenit 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës për rihapje të procesit në këtë Gjykatë, sikurse të ankimit kushtetues individual, janë të natyrës kumulative, pra ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse kriteret ligjore të lartpërmendura plotësohen në rastin në shqyrtim.

15. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e kërkesës për rihapjen e procesit, pasi ka qenë palë në procesin kushtetues, vendimin nr. 14/2018, të të cilit e ka ankimuar përpara GJEDNJ-së. Kjo e fundit, me vendimin e datës 4.2.2024, pasi ka konstatuar shkeljen e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar nga Gjykata, për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor ka vlerësuar se forma më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes do të ishte rihapja e procesit përpara kësaj Gjykate.

16. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, në rastin e kërkesave për rihapjen e procesit, Gjykata ka pohuar se llogaritja e afatit ligjor 4-mujor fillon nga hyrja në fuqi e vendimit të

gjykatës ndërkombëtare, pra nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 71/c, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës. Në rastin konkret vendimi i GJEDNJ-së për çështjen e kërkesit është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 41, datë 28.2.2025 dhe ai i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit në datën 8.4.2025, pra brenda afatit 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkesja e përmbush edhe kriterin *ratione temporis*.

17. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vlerëson të theksojë, fillimisht, se në rastet e rihapjes së procesit, kufijtë e shqyrtimit të çështjes përcaktohen nga shkaku i rihapjes. Kjo do të thotë se në rastet e rihapjes së procesit, kërkuuesi nuk mund të zgjerojë shkaqet e ankimit kushtetues fillestar dhe as të shtojë argumente të tjera në lidhje me to. Në të tilla raste Gjykata shfuqizon vendimin e mëparshëm të saj vetëm për atë pjesë për të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje nga ana e saj, pra vetëm për sa ajo (Gjykata) ka disponuar për rrëzimin e ankimit kushtetues fillestar. Nisur nga fuqia detyruese e vendimeve të GJEDNJ-së, e përcaktuar në nenin 46 të KEDNJ-së, detyrimi që lind në kuadër të zbatimit të vendimit të asaj gjykate në një rast konkret konsiston vetëm në shqyrtimin e atyre pretendimeve të kërkuarit, shqyrtim i cili përmbush detyrimet që rrjedhin nga KEDNJ-ja për korrigjimin e shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ-ja (*shih vendimet nr. 68, datë 5.11.2025; nr. 48, datë 22.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në kuptim të sa më sipër, duke pasur parasysh se kufijtë e shqyrtimit të çështjes përcaktohen nga shkelja e konstatuar nga GJEDNJ-ja, Gjykata vëren se ajo gjykatë ka gjetur shkelje të së drejtës për proces të rregullt në drejtim të standardit të arsytimit, për shkak se kërkuuesi nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues individual të datës 10.7.2018, shkak për të cilin GJEDNJ-ja ka vlerësuar se rihapja e procesit do të mundësojë në parim shqyrtimin e pretendimeve përmes një vendimi të arsyetuar (*shih paragrafët 21–22 të vendimit të GJEDNJ-së*). Prandaj, Gjykata vlerëson se natyra e kësaj shkeljeje është e tillë që kërkon marrjen në shqyrtim dhe dhënien përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të ngritura në ankimin e mëparshëm kushtetues dhe vetëm atyre, duke mos pasur legjitimitet kërkuari për të parashtruar pretendime ose argumente të tjera përtej atyre të paraqitura në vitin 2018. Gjithashtu, Gjykata vëren se në kërkesën në shqyrtim për rihapjen e procesit edhe vetë kërkuuesi ka kërkuar rishqyrtimin e çështjes së tij në tërësi, pra për të gjitha pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues të datës 10.7.2018.

19. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa për rihapjen e procesit është e bazuar dhe duhet të pranohet, duke shfuqizuar vendimin e saj nr. 14/2018, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës së datës 10.7.2018, të kërkuarit (ankimi kushtetues fillestar). Ndërkohë, për sa u përket pretendimeve të ngritura nga kërkuuesi në ankimin kushtetues të datës 10.7.2018, Gjykata vëren se ato kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së aksesit, parimin e paanshmërisë, parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, kërkuuesi ka parashtruar si argumente edhe se akuza ndaj tij është trajtuar mediatikisht, ku disa struktura politike kanë reflektuar opinion për fajësinë e tij. Gjykata vëren se ndonëse kërkuuesi ka barrën e provës për të provuar pretendimin e tij në këtë drejtim, për shkak të natyrës argumentuese të gjykimit kushtetues, ai nuk ka parashtruar asnjë akt provues në këtë drejtim, duke ngelur, për këtë shkak, një pretendim me natyrë të përgjithshme dhe i pamjaftueshëm për të vënë në dyshim procesin gjyqësor në këtë drejtim ose për të provuar se qëndrimet e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë janë ndikuar nga opinionet politike ose trajtimi mediatik i rastit të kërkuarit. Për rrjedhojë, këto argumente të kërkuarit në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nuk mund të merren në shqyrtim.

20. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuuesi, duke mbajtur në konsideratë natyrën dhe thelbin e tyre, Gjykata vlerëson se ato janë me natyrë kushtetuese ndaj do të shqyrtojnë në vijim, në themel, pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë, parimit

të prezumimit të pafajësisë, si dhe së drejtës për akses të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Po kështu, duke pasur parasysh se argumentet e tjera të parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të pretendimit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* bazohen mbi të njëjtat argumente të parashtruara edhe për cenimin e *parimit të paanshmërisë*, Gjykata çmon t'i analizojë këto pretendime së bashku.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe prezumimit të pafajësisë

21. Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarët që kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar rekursin e tij (Sh. S., A. Z., A. I. dhe T. N.) kanë marrë pjesë më parë në trupat gjykues që kanë shqyrtuar rekursin e ushtruara po nga ai gjatë fazës së hetimeve paraprake, për të cilat janë dhënë vendimet nr. 15, datë 16.1.2014 dhe nr. 832, datë 13.6.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Sipas kërkuesit, gjyqtarët Sh. S. dhe E. I. kanë shqyrtuar më parë një recurs tjetër të tij, që ka të bëjë me caktimin e masës së sigurimit ndaj tij, me vendimin nr. 1613, datë 20.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një procedim tjetër penal që ka lidhje me konfliktin që kërkuesi ka pasur me shtetasin D. L. Në këtë drejtim, kërkuesi ka argumentuar se ata gjyqtarë në shqyrtimin e shkaqeve të rekursit kishin krijuar bindjen e brendshme në lidhje me fajësinë e tij për veprat penale për të cilat akuzohej, dhe për këtë arsye është cenuar edhe parimi i prezumimit të pafajësisë.

22. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar duke argumentuar se vendimet nr. 832, datë 13.6.2013 dhe nr. 15, datë 16.1.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë dhënë për rekursin e paraqitura nga kërkuesi për masën e sigurimit personal dhe i takojnë një procesi gjyqësor të ndryshëm nga ai objekt kundërshtimi në këtë gjykim kushtetues. Po sipas subjektit të interesuar, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në të dyja vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të paanshmërisë.

23. Për sa i përket rastit të pjesëmarrjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të të njëjtit gjyqtar që ka marrë pjesë në seancën për vlefësimin e masës së arrestit, Gjykata ka konsideruar se gjykimi në Gjykatën e Lartë në të dyja rastet ka të bëjë me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta, të cilat janë marrë duke analizuar në tërësi provat dhe rrethanat e çështjes. Në vlerësimin e Gjykatës Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen për të kontrolluar ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankmuara. Në këtë kuptim, Gjykata ka çmuar se gjykimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet i njëanshëm vetëm për faktin se disa anëtarë të tij kanë marrë pjesë më parë në vlefësimin e masës së arrestit për të njëjtën çështje (*shih vendimin nr. 9, datë 11.5.2006, të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në të dyja vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme (*shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 6, datë 2.3.2018; nr. 22, datë 20.5.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Ndërsa në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, Gjykata ka theksuar se ky parim është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor, i cili kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Sipas Gjykatës, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.4.2025; nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 4, datë 21.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si

aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 12, datë 24.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Edhe në vlerësimin e GJEDNJ-së, thjesht fakti që një gjyqtar në një gjykatë penale është përfshirë edhe në vendimet që lidhen me paraburgimin për çështjen, nuk mund të justifikojë në vetvete frikën për paanshmërinë e tij, ajo që ka rëndësi është shkalla dhe natyra e këtyre vendimeve (*shih Fey kundër Austrisë, datë 24.2.1993, § 30*). Kur merr një vendim për paraburgimin dhe vendime të tjera paraprake të këtij lloji, gjyqtari vlerëson menjëherë të dhënat e disponueshme për të përcaktuar nëse ka baza *prima facie* për dyshimin kundër një të akuzuari për kryerjen e një veprë penale; kur jep vendimin në përfundim të gjykimit, ai duhet të vlerësojë nëse provat që janë paraqitur dhe debatuar në gjykatë mjaftojnë për ta shpallur të akuzuarin fajtor. Dyshimi dhe konstatimi formal i fajësisë nuk duhen trajtuar si çështje të njëjta (*shih Hauschildt kundër Danimarkës, datë 24.5.1989, §§ 49–50*).

26. Po kështu, GJEDNJ-ja ka pohuar se gjykatat duhet të jenë të paanshme edhe nga këndvështrimi objektiv, pra duhet të ofrojnë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Me fjalë të tjera, sipas testit objektiv, duhet të përcaktohet nëse, pavarësisht sjelljes personale të gjyqtarit, ka fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshime në lidhje me paanshmërinë e tij. Prandaj, kur vendoset nëse në një rast të caktuar ekziston një arsye legjitime për të pasur frikë se një gjyqtar i caktuar nuk ka paanshmëri, pikëpamja e të akuzuarit është e rëndësishme, por jo vendimtare. Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet e justifikuar objektivisht (*shih vendimin Jasiński kundër Polonisë, datë 20.12.2005, § 53*).

27. Duke iu kthyer rastit të kërkuarit, Gjykata vëren se pretendimet e tij janë parashtruar në drejtim të testit objektiv të parimit të paanshmërisë së gjykatës, ndaj për t'i dhënë përgjigje pretendimeve të tij duhet analizuar nëse Gjykata e Lartë, pjesë e së cilës ishin gjyqtarët për të cilët ka ngritur pretendimet kërkuari, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Me fjalë të tjera, Gjykata do të verifikojë nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë në dhënien e vendimit të mospranimin të rekursit dhe nëse dyshimi i kërkuarit është objektivisht i justifikueshëm.

28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga pesë gjyqtarë, në datën 8.6.2017, ka dhënë vendim për mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila e kishte deklaruar atë fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat ishte akuzuar (vendimi objekt i këtij gjykimi kushtetues), konkretisht “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”. Në vendimin e tij Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Katër nga anëtarët e trupit gjykues të Kolegjit Penal në këtë rast kanë qenë gjyqtarët Sh. S., A. Z., A. I. dhe T. N., për të cilët ka ngritur pretendimet kërkuari.

29. Ndërkohë, Gjykata konstaton se në datën 20.12.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga tre gjyqtarë, ndër të cilët edhe gjyqtarët Sh. S. dhe A. Z., për të cilët ka ngritur pretendimet kërkuari, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit në lidhje me çështjen me objekt “Vleftësim arresti e caktim mase sigurie”, dhënë ndaj kërkuarit për akuzën e kryerjes së veprës penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 236, paragrafi i dytë dhe 25 të KP-së. Ky vendim i Kolegjit Penal dhe ai i gjykatës së apelit objekt i shqyrtimit nga ai kolegji rezultojnë se nuk kanë lidhje me vendimet që kundërshton kërkuari në këtë gjykim kushtetues. Po ashtu, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga pesë gjyqtarë, ndër të cilët edhe katër gjyqtarët për të cilët ka ngritur pretendimet kërkuari, në datat 13.6.2013 dhe 16.1.2014, ka shqyrtuar rekursin e kërkuarit ndaj vendimit të gjykatës së apelit, e cila kishte disponuar për çështjet e kërkuarit me objekt “Caktimin e masës së sigurimit arresti në burg” (vendimi i datës

13.6.2013) dhe “Marrja në pyetje e kërkuesit me qëllim verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit arresti në burg” (vendimi datës 16.1.2014). Këto dy vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për të cilat ky i fundit ka disponuar me vendim për masën e sigurimit personal, lidhen me akuzën e ngritur ndaj kërkuesit “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “c”, i KP-së (ligji i kohës në momentin e kryerjes së veprës penale), për të cilën ai është dënuar me vendimet objekt të këtij gjykimi kushtetues.

30. Gjykata vëren, fillimisht, se ndonëse vendimet në të cilat kanë marrë pjesë gjyqtarët në fjalë janë dhënë brenda të njëjtit procedim penal, në të dyja rastet Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të saj, ka vendosur mospranimin e rekurseve, duke trajtuar çështje juridike të ndryshme. Kështu, në procesin e parë çështja juridike e shtruar përpara asaj gjykate kishte të bënte me vlerësimin e parashikimeve ligjore që kanë të bëjnë me caktimin e masave kufizuese të lirisë, pra me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm dhe kriterëve të tjera që, sipas dispozitave procedurale, lejojnë caktimin e masave kufizuese të lirisë, kurse në rastin e dytë, çështja juridike e shtruar përpara atyre gjyqtarëve kishte të bënte me vlerësimin e shkaqeve që lejojnë kundërshtimin e vendimit të fajësisë së kërkuesit (themeli i çështjes). Në këtë të fundit, Kolegji Penal ka shqyrtuar pretendimet e kërkuesit për vendimmarrjen e gjykatës së apelit që ka shqyrtuar në themel çështjen e fajësisë së tij, ku bazuar në provat që janë paraqitur dhe debatuar në atë gjykatë ai është deklaruar fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar. Pra, në këtë rast të fundit, Gjykata e Lartë me mospranimin e rekursit ka konfirmuar formalisht fajësinë e kërkuesit, bazuar në rrethanat e konstatuara dhe të pranuara prej Gjykatës së Apelit (mbi të cilat ajo ka zbatuar ligjin penal) dhe jo dyshimin e arsyeshëm për kryerjen prej tij të veprave penale. Në këtë mënyrë, Gjykata evidenton se pretendimi i kërkuesit se gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që kanë vendosur më parë për rekursin e për masat e sigurimit personal, kanë pasur paragjykim të papajtueshme me parimin e paanshmërisë dhe atë të prezumimit të pafajësisë nuk qëndron.

31. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se Gjykata e Lartë, sipas nenit 141 të Kushtetutës, ushtron rolin e saj si gjykatë ligji për të gjithë territorin e vendit dhe për shkak të kësaj karakteristike kushtetuese, në parim, nuk përjashtohet mundësia që i njëjti gjyqtar të japë disa vendime brenda të njëjtit proces gjyqësor, nëse çështjet ligjore që shqyrtohen janë të ndryshme. Gjykata, kur ka shqyrtuar pretendime për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar në dhënien e dy vendimeve në Gjykatën e Lartë, ka analizuar nëse vendimet e kundërshtuara janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve (*shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 22, datë 20.5.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në të cilën bënin pjesë gjyqtarët e kundërshtuar nga kërkuesi, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm dhe të ligjshëm në drejtim të testit objektiv të parimit të paanshmërisë së gjykatës, pasi nuk ka fakte bindëse që të vënë në dyshim ose të vërtetojnë paanshmërinë e tyre dhe dyshimi i kërkuesit nuk është objektivisht i justifikueshëm. Për më tepër, Gjykata vëren se gjyqtarët e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që kanë vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuesit për kundërshtimin e caktimit të masës së sigurimit personal, nuk rezultojnë që të jenë shprehur për fajësinë e tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe parimit të prezumimit të pafajësisë nuk janë të bazuara.

B.2 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyesimit të vendimit gjyqësor

33. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka analizuar pretendimet e tij të paraqitura në apelin kundërshtues dhe nuk ka analizuar pse vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte i drejtë, duke argumentuar gjithashtu se vendimi i asaj gjykate (gjykatës së apelit) është i paarsyetuar, kontradiktor, alogjik, konfuz dhe i bazuar në të njëjtat fakte e prova mbi të cilat

është bazuar edhe gjykata e shkallës së parë, por pa analizuar se ku ka gabuar kjo e fundit. Sipas kërkuarit, gjykata e apelit, pa asnjë analizë, duke iu referuar eksperimentit hetimor, ka arritur në një përfundim të gabuar të kohëzgjatjes së segmentit rrugor të Qafë-Kërrabës. Po sipas kërkuarit, ajo gjykatë pa asnjë hetim gjyqësor ose veprim tjetër hetimor ka ndryshuar vendndodhjen e dëshmitarit të mbrojtur. Në kërkesën e tij kërkuari pretendon se gjykata e apelit pranon praninë e automjetit të tij shumë kilometra larg vendit të ngjarjes në kohën kur ka ndodhur ngjarja, por arsyeton *a priori* se nuk shquhet prania e tij. Po sipas kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit vetëm me arsyetimin se pretendimet e ngritura në të nuk janë nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së, edhe pse në rekurs janë ngritur pretendime në lidhje me cenimin e procesit të rregullt ligjor nga gjykata e apelit, por ai kolegji nuk ka dhënë asnjë shkak se përse nuk duhej pranuar rekursi. Gjithashtu, kërkuari ka pretenduar se gjykata e apelit ka anashkaluar provat shkencore, duke marrë të mirëqena pretendimet dhe konkluzionet e organit të akuzës, pa analizuar pretendimet e mbrojtjes.

34. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar duke argumentuar se kërkuari e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të rekursit, të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar në dhomë e këshillimit, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar për shkaqet e ngritura në të. Sipas subjektit të interesuar, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë përmban të gjitha elementet e një vendimi të arsyetuar, sipas jurisprudencës kushtetuese, dhe nuk rezulton ndonjë e dhënë e cila të tregojë se gjykatat e kanë filluar procesin penal me paragjykimin se kërkuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka prapësuar duke argumentuar se nuk rezulton që gjykata e apelit të ketë kaluar barrën e provës nga prokurori tek i gjykuari ose të mos ketë vlerësuar dyshimet në favor të tij.

35. Gjykata ka theksuar se në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës, e drejta e aksesit i garanton individit të drejtën t'i drejtohet një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim që u jep përgjigje atyre (pretendimeve). Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 73, datë 17.10.2024; nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 48, datë 22.9.2025; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit (*shih vendimet nr. 30, datë 2.5.2025; nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Për sa më lart, Gjykata konstaton se pretendimet e kërkuarit parashtrihen në dy drejtime. *Së pari*, ai i ka ngritur pretendimet e tij lidhur me gjykatën e apelit, për të cilën, në thelb, ka pretenduar se nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të paraqitura në ankim, ka anashkaluar provat shkencore dhe ka marrë të mirëqena pretendimet e organit të akuzës, si dhe

vendimi i saj nuk plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij. *Së dyti*, kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka dhënë asnjë shkak se përse nuk duhej pranuar rekursi, ndërkohë që në të janë ngritur pretendime në lidhje me cenimin e procesit të rregullt ligjor nga gjykata e apelit.

38. Për rrjedhojë, referuar thelbit të pretendimeve të kërkuesit, në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese lidhur me gjykimin në gjykatën e apelit, Gjkata në vijim do të analizojë vendimin e asaj gjykate për të verifikuar nëse ajo ka anashkaluar prova duke marrë të mirëqena pretendimet e organit të akuzës, nëse kërkuesi ka marrë përgjigje për pretendimet e tij dhe nëse ai vendim plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij. Ndërsa për sa i përket gjykimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Gjkata do të verifikojë nëse kërkuesi ka ngritur pretendime në rekurs për cenimin e procesit të rregullt nga gjykata e apelit dhe nëse ato janë vlerësuar nga Gjkata e Lartë në kuadër të garancive që ofron neni 42 i Kushtetutës për procesin e rregullt ligjor për sa i takon së drejtës së aksesit lidhur me arsyetimin e vendimit gjyqësor.

39. Në rastin konkret, Gjkata konstaton se Gjkata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur deklarinin të pafajshëm të kërkuesit për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar. Po ashtu, rezulton se edhe kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësve të tij, ka paraqitur ankim kundërshtues, ku ka paraqitur argumentet e tij, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

40. Në vlerësimin e ankimit të organit të akuzës dhe ankimit kundërshtues të kërkuesit, Gjkata e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar dhe duke e dënuar përfundimisht atë me burgim të përjetshëm. Sipas gjykatës së apelit, përveç provave të tjera të administruara në gjykim, siç janë akti mjekoligjor nr. 76, datë 24.2.2013; akti nr. 274 prot., datë 15.3.2013; procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes, datë 24.2.2013; procesverbali i këqyrjes së automjetit me targë “TR 2564 N”, datë 24.2.2013; akti i këqyrjes së automjetit, datë 25.2.2013; deklarimi i shtetasit A. H. dhe akti “dokument filmim i regjistrueses” së lokalit “Old House”, nr. 2139, datë 25.2.2013, bazuar edhe në aktin “deklarim”, datë 22.10.2012, të dëshmitarit A. N., përfitohet dija se i pandehuri (kërkuesi), në drejtimin e automjetit ngjyrë gri, nga dritarja e shoferit ka qëlluar në drejtim të viktimës D. L. Po sipas asaj gjykate, në bagazhin e automjetit në pronësi të të pandehurit është gjetur një pardesy e zezë, ku në anën e majtë, nga brenda saj, ka mbishkrimin “AMADEUS”. Më tej, sipas gjykatës së apelit, nga pamjet filmike të përfituara në ambientet e kompanisë “AML” përfitohet njohja se veshja e sekuestruar është përdorur nga i pandehuri në momentin e kryerjes së ngjarjes dhe nga akti “ekspertim kimik” nr. 3234, datë 27.3.2012, sipas të cilit në pallton objekt ekspertimi me mbishkrimin “AMADEUS” u evidentua prania e nitriteve dhe e nitrateve që janë të pranishme edhe te mbeturinat e faktorëve plotësues të qitjes, përfitohet dija se i pandehuri ka qëlluar me armë zjarri. Rrjedhimisht, sipas gjykatës së apelit kjo e dhënë përputhet me atë të deklaruar nga dëshmitari A. N. Në vlerësimin e gjykatës së apelit janë këto të dhëna, që të përputhura me prova të tjera/të ndryshme nga vetë prova, dëshmia e dëshmitarit A. N., të cilat e bëjnë të besueshme dhe kështu të vërtetë dëshminë e tij për objektin e të provuarit, që është individualizimi i autorit të vrasjes, kërkuesi (*shih faqet 2–4 të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*).

41. Gjkata e apelit ka vijuar arsyetimin e saj duke analizuar dhe kundërshtuar vlerësimin që gjykata e shkallës së parë i ka bërë vendndodhjes së dëshmitarit A. N. dhe dëshmisë së dhënë prej tij, duke arsyetuar, ndër të tjera, se dëshmia e atij shtetasi është e vërtetë, pasi përputhet me provën e tërthortë, në lidhje me identifikimin e autorit, të përfutur nga akti “ekspertim kimik” nr. 3234, datë 27.3.2013. Sipas gjykatës së apelit, edhe konkluzioni i gjykatës së

shkallës së parë për vendndodhjen e dëshmitarit është jokorrekt dhe i pabazuar, pasi bazuar në dëshminë e tij, si dhe në vështrim të planimetrisë dhe fotografive të vendit për të cilin bën fjalë dëshmitari, është e qartë se ai është ndodhur në kthesën e rrugës “Ramazan Demneri” me rrugën “Ibrahim Dervishi”, por pa u futur në këtë të fundit, pikërisht aty ku ndodhet një kabinë telefoni ose roje. Në vlerësimin e gjykatës së apelit është e paprovuar alibia e kërkuesit për praninë e tij në vendin e quajtur karburant “Besmiri”, në rrugën pas kalimit të qytetit të Elbasanit, në orën 18:35 të datës 24.2.2013, për faktin jo vetëm se është provuar bindshëm prania e tij në vendin e ngjarjes, por edhe se nga filmimet e asaj pike karburanti vërehet prania e automjetit të kërkuesit, por jo prania fizike e tij. Po ashtu, gjykata e apelit ka arsyetuar se nga pamjet filmike të pikës së kalimit kufitar Kapshticë dhe të dhënat e sistemit TIMS është provuar se kërkuesi ditën e ngjarjes është gjendur fizikisht në pikën e kalimit kufitar Kapshticë në periudhën kohore 21:19–21:23, pra rreth 2 orë e 50 minuta pas ngjarjes për të cilën akuzohet. Nga ana tjetër, sipas gjykatës së apelit, referuar procesverbalit të eksperimentit gjyqësor të datës 25.2.2015, të udhëtimit nga vendi i ngjarjes deri në pikën e kalimit kufitar Kapshticë, përftohet dija se ky segment rrugor është përshkruar në kohën 2 orë e 45 minuta (18:30 – 21:15), e kështu i mundur të përshkohet nga kërkuesi dhe rrjedhimisht e paprovuar edhe alibia e tij (*shih faqet 5–7, të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*).

42. Gjykata konstaton se kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi, duke parashtruar edhe shkaqet e tij. Referuar këtyre shkaqeve, kërkuesi, ndër të tjera, ka parashtruar në rekurs se sipas tij është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi vendimi i gjykatës së apelit ishte rrjedhojë e një reflektimi të opinioneve të disa strukturave politike, të cilat *a priori* e kishin deklaruar fajtor atë përpara se të ishte provuar fajësia e tij, dhe se ajo gjykatë e ka dënuar atë si pasojë e presionit politik e mediatik. Po sipas rekursit të kërkuesit, gjykata e apelit e ka dënuar vetëm mbi bazën e një prove të vetme, siç ishte dëshmia e shtetasit A. N. Në këtë kuptim, sipas pretendimeve të kërkuesit të parashtruara në rekurs, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk e ka provuar fajësinë e tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm (*paragrafët e tretë, të katërt dhe të pestë, të faqes 18, të rekursit dhe paragrafi i parë, i faqes 19*).

43. Referuar përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në pjesën hyrëse të tij, ku parashtrohen pretendimet e rekursuesit, ai kolegji, ndër të tjera, ka pasqyruar edhe pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nga gjykata e apelit (*shih faqen 10 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Po ashtu, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuesi në rekurs, ka arsyetuar: “Rezulton se palët kanë dijeni për rekursin. Rekursi i paraqitur nga i gjykuari Arben Frroku, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së”. Në përfundim, Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit.

44. Për sa më lart, referuar pretendimeve të kërkuesit dhe analizimit të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Gjykata, fillimisht, konstaton se gjykata e apelit, pasi ka marrë në shqyrtim dhe analizuar pretendimet e palëve të parashtruara në mjetet e ankimit, si dhe provat e paraqitura nga organi i akuzës, ka arsyetuar vendimin e saj në lidhje me vlerësimin e çështjes, duke u dhënë përgjigje në thelb pretendimeve të kërkuesit të paraqitura në apelin kundërshtues, si dhe duke analizuar edhe shkaqet pse vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte i drejtë dhe duhej ndryshuar. Po ashtu, Gjykata konstaton se ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin e shprehur në dispozitivin e vendimit të saj duke bërë një shqyrtim dhe analizë në tërësi të provave, dhe pa marrë të mirëqena pretendimet ose konkluzionet e organit të akuzës. Ajo gjykatë, në përputhje me të dhënat e rezultuara nga eksperimenti, sipas procesverbalit të kryerjes së tij, i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimit të kërkuesit për pamundësinë e tij për të qenë në vendin e ngjarjes, duke iu referuar për këtë qëllim kohës së mjaftueshme për të përshkruar segmentin rrugor nga vendi i ngjarjes deri në

pikën e kalimit kufitar. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata konstaton se gjykata e apelit nuk ka ndryshuar vendndodhjen e dëshmitarit dhe nuk ka arsyetuar *a priori* për mosvendndodhjen e kërkuesit në automjet në rrugën pas kalimit të qytetit të Elbasanit, por në vlerësimin dhe arsyetimin e saj për këto fakte, ajo gjykatë është bazuar në provat e administruara dhe të shqyrtuara gjatë gjykimin. Në vlerësimin e Gjykatës, pretendimi i kërkuesit se vendimi i gjykatës së apelit është i paarsyetuar, kontradiktor, alogjik ose konfuz, është i pabazuar.

45. Për sa i përket procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Gjykata vlerëson se vetëm fakti se Kolegji Penal i asaj gjykate ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi dhe nuk i ka dhënë përgjigje çdo pretendimi të tij, nuk vë në dyshim të drejtën e kërkuesit për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë këndvështrim, edhe pse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e ngritur në rekurs për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, në kontekstin e rrethanave të rastit në shqyrtim dhe pabazueshmërisë në thelb të këtij pretendimi (*shih paragrafin 32 të këtij vendimi*), kjo mangësi nuk është e atillë që të çojë në përfundimin se arsyetimi i vendimit të kundërshtuar në këtë rast ka cenuar të drejtën e kërkuesit për proces të rregullt ligjor.

46. Ndërsa lidhur me arsyetimin e vendimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se vendimi i atij kolegji në pjesën hyrëse të tij përmban shkaqet e ngritura në rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe në pjesën arsyetuese shkakun se pse rekursi nuk duhej të pranohej. Në vlerësimin e Gjykatës edhe vendimi i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, nuk rezulton të mos ketë respektuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv. Ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e Kolegjit Penal në vështrim të nenit 432 të KPP-së për natyrën e këtyre shkaqeve. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

47. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe prezumimit të pafajësisë, si dhe të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71/c, 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit në Gjykatën Kushtetuese.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 14, datë 24.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese.
 3. Rrëzimin e ankimit kushtetues individual të kërkuesit.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.2.2026.

Shpallur më 3.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Asim Vokshi

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes me kërkues Arben Frroku dhe me objekt *“Rihapja e procesit gjyqësor dhe shfuqizimi i vendimeve nr. 73, datë 29.6.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë; nr. 00-2017-443, datë 8.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim pranë gjykatës kompetente, duke urdhëruar rigjykimin e saj me tjetër trup gjykues”*, ne, gjyqtarët Ilir Toska dhe Sonila Bejtja, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar, duke u vendosur shfuqizimi i vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për shqyrtim në atë gjykatë.

2. Fillimisht, vlerësojmë të parashitshmë se ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën në lidhje me pabazueshmërinë e pretendimeve të kërkuesit për cenimin e paanshmërisë dhe të prezumimit të pafajësisë, për sa ky i fundit është mbështetur në argumente që lidhen me mungesën e paanshmërisë së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Po ashtu, ndajmë të njëjtin qëndrim edhe për pabazueshmërinë e këtij pretendimi të mbështetur në argumentin se çështja e tij është paragjykuar për shkak të trajtimit mediatik të saj dhe të pasqyrimin të një opinioni për fajësinë e tij nga disa struktura politike.

3. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe, përmes tij, me pretendimet për cenimin e parimeve të prezumimit të pafajësisë dhe të barazisë së armëve e kontradiktoritetit, ndryshe nga shumica, mbajmë qëndrimin se ai është i bazuar. Për rrjedhojë, në vijim do të parashitshmë argumentet për qëndrimin tonë.

4. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin e datës 3.4.2015, në mënyrë unanime, e ka deklaruar kërkuesin të pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohej, pasi, në analizë të provave të marra dhe të shqyrtuara në gjykim, ka vlerësuar se nuk provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai i kishte kryer ato vepra penale. Mbi ankimin e organit të akuzës, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin e datës 29.6.2015, me shumicë votash, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar kërkuesin fajtor për veprat penale për të cilat akuzohej, konkretisht *“Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”* dhe *“Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municionit”*, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “c”, dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (KP), duke e dënuar atë me burgim të përjetshëm, pasi, mbi bazën e rivlerësimit të të njëjtave prova, ka arritur në një përfundim të kundërt me atë të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprat penale. Në vijim, për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 8.6.2017, pas shqyrtimit paraprak të tij, ka vlerësuar se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikonte neni 432 i KPP-së, duke vendosur mospranimin e tij.

5. Neni 432 i KPP-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së rekursit nga kërkuesi, parashikonte se rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhej për këto shkaqe: a) për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal; b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij kodi; c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Kurse neni 433 i tij, në kohën e shqyrtimit të rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë, parashikonte se rekursi nuk pranohej në qoftë se bëhej për shkaqe të ndryshme nga ato që lejonte ligji dhe se mospranimi i tij vendosej nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve.

6. Ndërkohë, në rekursin e tij kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar se gjykata e apelit ka vepruar në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi fajësia e tij nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas kërkuesit, dënimi i tij është bazuar në thelb mbi një provë të vetme, deklaratimet e personit të mbrojtur A. N., deklaratimet e të cilit kanë qenë të pabesueshme, për shkak se, jo vetëm se ai ka qenë në konflikt të hapur interesi, por edhe se deklaratimet e tij ishin krejt kontradiktore me deklaratimet e personave të tjerë, të cilat e shfajësonin atë nga akuzat e ngritura. Edhe deklaratimet e tre dëshmitarëve të tjerë, konkretisht të dy punonjësve të policisë dhe të bashkëshortes së personit të mbrojtur, të cilët u janë referuar thëniet e këtij të fundit, nuk mund të përdoren kundër tij për sa kohë nuk e kanë parë vetë ngjarjen dhe autorin e saj. Po sipas tij, referuar praktikës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, fajësia në një proces penal nuk mund të konkludohet duke u bazuar vetëm në një provë të vetme nëse ajo nuk shoqërohet me prova të tjera mbështetëse. Në këtë kuptim, sipas kërkuesit, dyshimet për akuzën gjykata e apelit nuk i ka çmuar në favorin e tij, duke shkelur nenet 4 dhe 152 të KPP-së, ndërsa i ka çmuar provat në mënyrë të njëanshme.

7. Po ashtu, në rekurs, kërkuesi ka pretenduar edhe se gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë dëshmitë e disa shtetasve, të cilët ishin të afërm ose bashkëpunëtorë të tij, me arsyetimin tendencioz se ata kanë lidhje familjare, gjinore, miqësore ose pune me të. Gjithashtu, ajo gjykatë nuk ka marrë parasysh as dëshmitë e disa personave të tjerë, të cilët kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes. Këto dëshmi, sipas kërkuesit, nuk përputhen me ato të personit të mbrojtur A. N., ndërkohë që ato provonin pafajësinë e tij. Provat në fjalë, që shkonin në favor të tij, sipas kërkuesit, gjykata e apelit as nuk i ka përmendur në vendim, ndërsa ka pranuar si të mirëqenë pretendimin e organit të akuzës se në datën 24.2.2013, ai ka kryer vrasjen në Tiranë dhe, më pas, është larguar për në shtetin grek. Për sa më sipër, në kuadër të nenit 432 të KPP-së së kohës, pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs lidheshin me standardin e të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm, me vlerësimin e njëanshëm të provave nga gjykata e apelit, me mosmarrjen në konsideratë të provave shfajësuese dhe me cenimin nga ajo të parimeve të prezumimit të pafajësisë, barazisë së armëve e kontradiktoritetit, duke përbërë, në thelb, pretendime për zbatim të gabuar të ligjit penal dhe për shkelje procedurale që, sipas tij, kishin ndikuar në dhënien e vendimit.

8. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret mbajtëm qëndrimin se pretendimet në rekursin e kërkuesit në lidhje me parimet e prezumimit të pafajësisë dhe barazisë së armëve e kontradiktoritetit, të lidhura me standardin e arsyetimit të vendimit nga gjykata e apelit, duke qenë me natyrë kushtetuese, kanë qenë të tilla që kërkonin një përgjigje të shprehur dhe të arsyetuar nga Gjykata e Lartë përpara se ato, në respektim të parimit të subsidiaritetit, t'i nënshtroheshin kontrollit kushtetues.

9. Në lidhje me këtë, mbajtëm në konsideratë jurisprndencën e Gjykatës, e cila ka theksuar se aksesin në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 62, datë 23.10.2025; nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe se e drejta e ankimit, sipas nenit 43 të Kushtetutës, është një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individi) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, ndërsa çdo instancë ankimuese është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 45, datë 3.7.2017; nr. 38, datë 30.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në të njëjtën linjë, edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së ka pranuar se garancitë e nenit 6 zbatohen, në parim, edhe për rekursin në kasacion, kur këto përbëjnë një fazë të mëtejshme të procedurës penale dhe kur rezultatet e tyre mund të jenë vendimtare për personin e dënuar (*shih Meftah dhe të tjerë kundër Francës [DhM], nr. 32911/96 dhe të tjerë, 2002, § 40*). Po ashtu, GJEDNJ-ja ka theksuar se ndonëse e drejta e apelit mund t'u nënshtrohet kushteve ligjore, gjykatat duhet, në zbatimin e rregullave procedurale, të shmangin një formalizëm të tepruar që

do të cenonte rregullsinë e procedurës dhe vetë thelbin e së drejtës për akses në një gjykatë, sidomos duke pasur parasysh rëndësinë e ankimit dhe mundësinë që ai i jep një të dënuari me një masë të rëndë heqjeje lirie për t'iu nënshtruar shqyrtimit nga gjykata më e lartë (*shih Walchli kundër Francës, nr. 35787/03, 2007, § 29; Labergère kundër Francës, nr. 16846/02, 2006, §§ 20, 23*).

11. Po ashtu, mbajtëm në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës, standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtës së aksesit në gjykim dhe të drejtën e ankimit efektiv dhe se në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, atij i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 58, datë 13.11.2023; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, ka theksuar Gjykata, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme dhe, në mënyrë të veçantë, i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 67, datë 5.11.2025; nr. 20, datë 11.4.2025; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), e cila, në kuadër të parimit të *subsidiaritetit*, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 27, datë 29.5.2025; nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Pikërisht referuar këtyre standardeve kushtetuese dhe konventore, në vlerësimin tonë, mosdhënia e një përgjigjeje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për pretendime me natyrë kushtetuese, nuk i jep mundësi Gjykatës të vlerësojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve të tilla, pikërisht për sa kohë që, në respektim të parimit të subsidiaritetit, ato nuk janë shqyrtuar dhe vlerësuar më parë nga gjykatat e zakonshme, të cilat, për pasojë, nuk i kanë siguruar individit një përgjigje të arsyetuar dhe përfundimtare në lidhje me to. Një qasje të tillë Gjykata e ka mbajtur në vijimësi në të gjitha ato raste kur Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, të cilat, në kontekst të rrethanave konkrete, nuk dukeshin haptazi të pabazuara dhe që, për këtë arsye, kërkohej një përgjigje e arsyetuar prej saj, në përmbushje të rolit si gjykatë ligji.

13. Ky standard merr rëndësi edhe më të shtuar në procesin penal, sidomos kur çështja lidhet me vlerësimin e deklarimeve të dëshmitarëve dhe me standardin e të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka theksuar se kur një gjykatë apeli është thirrur të shqyrtojë çështjen në fakt dhe në ligj dhe të vlerësojë në tërësi çështjen e fajësisë ose të pafajësisë, ajo nuk mund, për arsye të rregullsisë së procesit, të vendosë për këto çështje pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të deklarimeve të dëshmitarëve. Në veçanti, kur gjykata e apelit përmbys një vendim pafajësie, duke u larguar nga vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë për sa i përket besueshmërisë së dëshmitarëve kyç, ajo nuk mund të mjaftohet me leximin e deklarimeve të tyre të pasqyruara në procesverbale, pasi vlerësimi i besueshmërisë së një dëshmitari është një veprimtari komplekse që, normalisht, nuk mund të kryhet nëpërmjet një leximi të thjeshtë të përmbajtjes së deklarimeve të tij. Përgjashtimisht, një qasje e tillë mund të justifikohet vetëm kur ekzistojnë pengesa objektive që e bëjnë të pamundur dëgjimin personal të dëshmitarit, gjë që duhet të rezultojë konkretisht nga rrethanat e çështjes (*shih Dan kundër Moldavisë, nr. 8999/07, 2011, §§ 30–33; Lorefice kundër Italisë, nr. 63446/13, 2017, §§ 36–46*).

14. Për rrjedhojë, në rastin konkret, mendojmë se Gjykata e Lartë nuk ka vepruar në përputhje me rolin dhe funksionin e saj për kontrollin edhe të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor të zhvilluar nga gjykata e apelit. Për më tepër kur në këtë rast ndodhemi edhe përpara dy vendimeve diametralisht të kundërta të gjykatave të faktit, të cilat, mbi të njëjtat prova, kanë arritur në përfundime tërësisht të kundërta në drejtim të standardit të të provuarit tej çdo

dysimi të arsyeshëm. Në situata të ngjashme, Gjykata ka vlerësuar se në kushtet kur për çështjen e fajësisë së kërkuesit kishte dy vendime diametralisht të kundërta dhe pretendimet e tij përfshiheshin brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit, në respektim të standardit të arsytimit të vendimit, duhet t'u kishte dhënë përgjigje dhe të shprehej për to, në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit (*shih vendimin nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe në këndvështrimin e standardeve të GJEDNJ-së, një situatë e tillë kërkonte që Gjykata e Lartë të tregonte, së paku, përmes një minimumi arsytimi, se pse pretendimet e kërkuesit, që lidhen me besueshmërinë e provës kyçe, me mungesën e provave mbështetëse, me mosmarrjen në konsideratë të provave shfajësuese dhe me standardin e prezumimit të pafajësisë, ishin të papranueshme ose haptazi të pabazuara. Ndaj edhe në këtë këndvështrim, si dhe duke pasur në konsideratë llojin më të rëndë të dënimit me burgim të caktuar ndaj kërkuesit, Gjykata e Lartë duhet të kishte treguar kujdes të shtuar, për të mbajtur qëndrim të shprehur për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekursin e tij.

15. Në këto kushte, arsytimi i Gjykatës së Lartë se rekursi i kërkuesit nuk përmban shkaqe nga ato që parashikonte neni 432 i KPP-së, nuk mund të konsiderohet një arsyetim i kufizuar që plotëson standardet kushtetuese në këtë drejtim dhe as standardet konventore të nenit 6 të KEDNJ-së, ndërsa kjo mënyrë arsytimi nuk të jep mundësi për të verifikuar sesi ajo gjykatë ka vlerësuar shkaqet e rekursit, duke arritur në përfundimin se ato nuk përfshiheshin në rastet për të cilat ligji procedural lejonte rekurs apo se ato ishin haptazi të pabazuara. Një formulë e tillë e zhveshur nga arsytimi nuk lejon të kuptohet nëse Gjykata e Lartë ka identifikuar natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura, nëse i ka shqyrtuar ato realisht dhe përse ka arritur në përfundimin se ato nuk kërkonin shqyrtim të mëtejshëm. Në këtë kuptim, vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit pa një arsyetim real për natyrën dhe trajtimin e pretendimeve të ngritura në të, e ka bërë aksesin e kërkuesit në atë gjykatë vetëm formal, por josubstancial dhe efektiv.

16. Për sa më lart, mbajtëm qëndrimin se i takonte Gjykatës së Lartë që të ndalej, më së pari, në vlerësimin e pretendimeve në rekurs të kërkuesit, duke mbajtur një qëndrim të shprehur për to dhe duke arsyetuar nëse ato përfshiheshin ose jo në ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së apo nëse ishin haptazi të pabazuara. Mospranimi i rekursit nga Gjykata e Lartë në rastin konkret, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsytimin e kufizuar për papranueshmërinë e tij, në vlerësimin tonë, nuk përmbush standardin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor, për pasojë cenon edhe të drejtën e kërkuesit për akses në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, kërkesa e kërkuesit duhej të ishte pranuar.

Anëtarë: Ilir Toska, Sonila Bejtja